



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 43 dt.30.04.1996

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e dt.30.04.1996, vendosi që të rivlerësohet autorizimi për apartament dhe leja e banimit dhe të vlerësohet statusi i të pastrehit, respektivisht :

VENDOSI

1. Autorizimi për apartamentet dhe leja e banimit rivlerësohet nga 50(pesëdhjetë) në 500(pesëqind) lekë.
2. Vlerësohet me 100(njëqind) lekë statusi i të pastrehit.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Seksioni i Strehimit të Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA